



DEKLARATË

Grupimi Qytetar Pro Reformës në Drejtësi

Bashkohuni me ne!

Grupimi Qytetar pro Reformës në Drejtësi, (GQRD) i përfaqësuar nga organizata jofitimprurëse, aktivistë të shoqërisë civile, personalitete publike e qytetarë të thjeshtë, duke marrë shkas nga ngërçi ku është futur ky proces historik dhe një rol i paprecedent i faktorit ndërkombëtar, diktuar nga sjellja e klasës sonë politike, i drejtohet me një apel mbarë opinionit publik dhe deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këto 26 vite postkomunizëm, qytetarët e vendit tonë, në përpjekje për ndërtimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, janë përballur me një sistem drejtësie që ka kontribuar në instalimin e padrejtësisë dhe pandëshkueshmërisë së krimit. Për shkak të korrupsionit, paaftësisë dhe politizimit, kjo drejtësi ka ndikuar në krijimin e një shtrese të privilegjuar të shoqërisë, përbërë nga njerëz të veshur me pushtet politik dhe ekonomik, që kanë vepruar në dëm të interesave të vendit dhe qytetarëve. Reformimi i këtij sistemi mori një angazhim të faktorit ndërkombëtar si asnjëherë tjetër, duke dëshmuar paaftësinë dhe mungesën e dëshirës së klasës sonë politike për të prodhuar një drejtësi të vërtetë, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë. Ne jemi të bindur se para se të jetë kusht për integrimin e Shqipërisë në BE, kjo reformë duhet të jetë kusht për të bërë drejtësi për ne, këtu, në vendin tonë. Në kushtet kur mekanizmat e drejtësisë “sovrane” të ndërtuara edhe me konsensus politik nuk kanë dhënë drejtësi, dhe kur besimi ndaj politikanëve tanë në popull është në nivelin më të ulët historik, prezenca e dy partnerëve strategjike,



BE dhe SHBA, është një garanci për reformimin real të sistemit të drejtësisë. Pavarësisht rolit të tyre, reformimi i sistemit të drejtësisë ka qënë dhe mbetet përgjegjësi e klasës politike shqiptare e cila ka sot shancin t'i tregoje popullit të vet se është për të luftuar krimin, korrupsionin dhe vënien e drejtësisë në vend. Ne mbështesim miratimin e reformës me konsensus të gjërë politik, por kërkojmë në mënyrë të prerë që konsensusi i domosdoshëm të mos shndërrohet në pazar politik, përmes të cilit është kontrolluar dhe deformuar deri tani drejtësia, duke siguruar vetëm privilegjin para ligjit të atyre që kanë patur pushtetin. Ne u bëjmë thirrje deputetëve që të veprojnë jo nën komandën e partive të tyre, por nën komandën e interesave të popullit, interesave të njerëzve që i kanë votuar, interesave të vendit për sot dhe për të ardhmen. Ne u bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve që duan të jetojnë në një vend, ku para ligjit të jenë të gjithë të barabartë dhe ku drejtësia të mos këmbëhet si mall në treg, të na bashkohen në aksionet që do të ndërmarrim në ditët në vijim, përtej bindjeve politike apo interesave të tyre personal. Drejtësia është shtylla kurrizore e shtetit dhe shteti na përket të gjithëve!

Act For Society

Albanian Community Assist

Aleanca Kundër Importit të Plehrave (AKIP)

Alfred Moisiu

Blendi Salaj

EU Policy Hub

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë



Forumi i Mendimit të Lirë

Instituti i Studimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

IRCA

Këshilli Rinor i Ambasadës Amerikane në Shqipëri

Këshilli Studentor i Universitetit të Korçës

Klubi Ekologjik Elbasan

Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri

Koalicioni për Zgjedhje të Lira, të Ndershme e Demokraci të Qëndrueshme

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lëvizja Evropiane në Shqipëri (EMA)

Lëvizja MJAFT

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

People in Focus

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë", Shkodër

Qendra për Studimin e Politikave Evropiane për Zhvillimin Rajonal dhe Lokal (CRLDS)



Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS

Shoqata Sarda

Shpresa për të ardhmen, Shkodër

Social Education & Environment Protection (SEEP), Vlorë

Tirana Ekspres

YouthAct

Y-PEER Albania

Local Economic Development Agency (Auleda), Vlorë

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara